




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 31 maj 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2021_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

- Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7., Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2 dhe Nenin 44 paragrafi 1 nënpar. 1.2 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 2 par 1 nënpar. 2.5 të Ligjit për Nr. 04/L-045 për Partneritetin Publiko Privat, Kërkesën nr. 4043 të datës 23.04.2024, e Ministres së Ministrisë për Ekonomi të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 31 maj 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. Për ndërtimin e projektit specifik prej 150 MW të prodhimit të energjisë nga era nuk aplikohet Procedura e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve Gjeneruese, i cili proces do të zhvillohet në pajtim me Ligjin Nr.04/L-045 për Partneritetin Publiko Privat.
- II. Ky vendim nuk e ndalon apo kufizon aplikimin apo shfrytëzimin e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapacitete gjeneruese për projekte të energjisë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084).

A r s y e t i m

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 23.04.2024 nga Ministria e Ekonomisë e Qeverisë së Republikës së Kosovës ka pranuar kërkesën për vlerësim të përshtatshmërisë dhe arritjes së objektivave të Strategjisë së Energjisë, duke shfrytëzuar procedurën e autorizimit për të arritur caqet e burimeve të ripërtëritshme, me theks ato të lidhura me teknologjinë e Erës. Ministria e Ekonomisë, duke përdorur fonde nga mekanizmat ndërkombëtarë siç është Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Rezistencën dhe Qëndrueshmërinë (RSF), synon të bëjë bashkë investim me sektorin privat në ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në teknologji të ripërtëritshme me erë të një kapaciteti deri në 150 MW, sipas një skeme të partneritetit publik-privat.
- o Ministria e Ekonomisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Rezistencën dhe Qëndrueshmërinë (RSF) me datë 22.03.2024 kanë arritur marrëveshje për shërbime për tërheqjen e investimeve të sektorit privat për projektin e prodhimit të Erës, duke përfshirë projektimin, financimin, ndërtimin dhe funksionimit të gjeneratorit të Erës të paktën me kapacitet total prej 150 MW, përmes një partneriteti publiko privat me qëllim që të identifikoj dhe të përzgjedh në bazë konkurruese një pjesëmarrës në sektorin privat për projektin.



- Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës për vitet 2022 – 2031 parasheh që deri në vitin 2031 Kosova të ketë në total 1600 MW kapacitete të instaluar bazuar në teknologji nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.
- Ligji Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë parasheh zhvillimin e kornizës rregullative për promovimin e përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në Republikën e Kosovës, duke përfshirë promovimin e Skemave Mbështetëse konkurruese, transparente dhe mekanizma të tjerë të partneritetit publiko-privat.
- Ligji për Nr. 04/L-045 për Partneritetin Publiko Privat parasheh se me këtë ligj rregullohet Partneriteti Publiko Privat për ofrimin e shërbimeve dhe të infrastrukturës publike në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror, duke përfshirë edhe atë nëse me Ligjin për Rregullatorin për Energji për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, kërkohet zbatimi i dispozitave të këtij ligji.
- Udhëzimi Administrativ (ME) Nr. 02/2023 për Cakun e Energjisë Elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë në Shtojcën I (Kapaciteti i Energjisë Elektrike nga BRE (MW)) parasheh trajektoren kombëtare për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese bazuar në teknologjinë e Erës në një kapacitet prej 677 MW deri në vitin 2030. Për të siguruar përmbushjen e caktuar afatgjatë dhe vjetor të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë do të përdoren edhe masa mbështetëse përmes procedurave konkurruese.
- ZRRE me Vendimin V_1321_2020 të datës 10 Dhjetor 2020 ka ndërprerë aplikimin e Skemës Mbështetëse me “tarifë nxitëse” për BRE-të, dhe ka vendosur që të gjitha aplikacionet e pranuar dhe të regjistruara në ZRRE para datës 10 dhjetor 2020 dhe që janë brenda caqeve të vitit 2020, janë trajtuar sipas kornizës ligjore/rregullative në fuqi në kohën e aplikimit.
- Gjithashtu është vendosur që në pajtim me detyrimet ligjore dhe në bashkëpunim me Institucionet e Republikës së Kosovës, Zyra e Rregullatorit për Energji do të ndërmerr veprime për zhvillim të projekteve nga burimet e ripërtëritshme të energjisë për arritjen e caqeve 2021-2030 përmes formave të ndryshme të ankandëve, në përzgjedhjen e përfitueseve nga format tjera mbështetëse përmes tarifave Premium ose të ngjashme, konform praktikave më të mira në favor të interesit publik.
- ZRRE ka miratuar Metodologjinë Nr. 01/2023 për përcaktimin e premiumit të fiksuar maksimal, çmimit të fiksuar maksimal dhe tarifës nxitëse maksimale me qëllim të promovimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme që bazohen në mekanizma konkurrues, e cila mundëson përcaktimin e çmimit maksimal që mund të përdoren në ankandet bazuar në procedurën konkurruese.
- ZRRE sqaron se nga kapaciteti total prej 667 MW teknologji e Erës e paraparë të jetë e instaluar deri në vitin 2030, aktualisht sipas procedurës së autorizimit në operim janë gjithsejtë 137 MW bazuar në teknologjinë e Erës.
- ZRRE përmes vendimeve ka pranuar sipas kornizës së rregulluar dy (2) projekte bazuar në teknologjinë nga Era, me një kapacitet prej 70 MW (2 x 35 MW) me çmime referent që përcaktohet sipas Metodologjisë në baza vjetore, projekte të cilat janë në fazën finale të kompletimit të



dokumentacionit të ndërtimit sipas kërkesave ligjore të legjislacionit të aplikueshëm dhe kërkesave ligjore të përcaktuara me vendimet përkatëse në bazë të Procedurës së Autorizimit.

- ZRRE vlerëson se për të arritur cakun prej 677 MW nga teknologjia e Erës deri në vitin 2030, duke konsideruar se 70 MW të pranuar në kornizën e rregulluar do të rezultojnë në realizim të suksesshëm, në vitet në vazhdim nevojiten të ndërtohen kapacitete shtesë prej 470 MW nga teknologjia e Erës deri në vitin 2030.
- ZRRE gjithashtu vlerëson nevojën për ndërtimin edhe përmes formave tjera të mbështetjes është e domosdoshme për të arritur caqet deri në vitin 2030, bazuar në teknologjinë e Erës.
- ZRRE gjithashtu ka parasysh edhe rezultatet e ankandit solar prej 100 MW të organizuar nga Ministria e Ekonomisë dhe çmimin përfundimtar të pranuar.
- ZRRE po ashtu vlerëson se zhvillimi i proceseve konkurruese dhe themelimi i skemave mbështetëse është në përputhje me obligimet që rrjedhin nga Komuniteti i Energjisë.
- ZRRE sqaron se bazuar në Rregullën Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse ka lëshuar autorizime preliminare “në pritje” me një kapacitet total prej 170.3 MW për tu pranuar në skemën mbështetëse të cilat nuk kanë mundur të procedohen tutje, sepse nuk ka pasur caqe të disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2017 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik i cili tanimë është shfuqizuar. Prandaj, me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. ME) Nr. 02/2023 me të cilën është vendosur përmbushjen e caktuar afatgjatë dhe vjetor për periudhën 2022-2031 të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë do të përdoren edhe masa mbështetëse përmes procedurave konkurruese, edhe këta aplikues mund t’iu nënshtrohen procedurave konkurruese apo edhe të vazhdojnë me kushte të tregut sipas legjislacionit të aplikueshëm.
- ZRRE pas vlerësimit dhe analizimit të gjendjes ekzistuese, me qëllim të arritjes së objektivave të Strategjisë së Energjisë, ka vendosur që të lejohet shfrytëzimi i procedurës së tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për projektin specifik të Erës prej 150 MW për përmbushjen e caqeve të energjisë nga Burimet e Ripërtëritshme, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-045 për Partneritetin Publiko Privat.
- Prodhuesi i Privilegjuar i përzgjedhur si ofertues i suksesshëm përmes Procesit të Ofertimit Konkurrues që lidh Marrëveshje për Zhvillim të Projektit me Ministrinë e Ministrisë nuk i kërkohet të aplikojë për autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.





Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Ministrisë së Ekonomisë, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.